

KOSOVË RJA

Ballina: Lendita Frroki
Foto: Admir Saiti

**Kush
po e sjellë
Kosovën
në gisht**

**Shqiptari
që fle një javë
me njërën grua,
e një javë
me tjetrën**

**Dikur
s'kishte mjek,
por as sëmundje
si tash**

**Nuk e kam ditur
se burrin e kam
Donzhuan**

**Tuna:
Ku rafsha
mos u vrafsha**

**E veçanta
Linda, nga
"Beauty's
Linda"**

**LENDITA FRROKI DHE
"VIP NAILS & BEAUTY"
perandoria shqiptare
e bukurisë në Zvicër**

remos

a.g.e.stop
SWITZERLAND

Fortesa
WOMAN

JARDIN
GARDEN DESIGN

allure

UNIK
HOTEL

CIMA
HOTEL & SPA

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj

DENTFIX

Shkunda Dikera
WOMAN

SHERWOOD
HOTEL & SPA

iAs

Canaderm



Qeramike

Hotel

Ndërtim

Beton

Gurthyes



✉ info@dino-company.com

☎ +383 44 206 685

🌐 +381 35 566 666

Ç'profesione kanë të njohurit tanë?



ZIJA REXHEPI, MODERATOR, AKTOR, PROFESOR

U lind në Preshevë. Studimet master në fushën e Komunikimit dhe Gazetarisë i ka mbaruar në Prishtinë. Zija Rexhepi njihet si njëri nga moderatorët më të mirë televizivë. Karrierën e moderatorit e filloi në RTV 21, pastaj në RTK, ndërkaq tash është në ATV. Por, Zija me profesion është aktor. Aktrimin e ka adhuruar prej fëmijërisë dhe kjo ka qenë një ëndërr, të cilën edhe e ka realizuar. Gjatë studimeve dhe pas tyre ai ka marrë pjesë në shumë videoprojekte dhe shfaqje teatrale. Është profesor në AAB.



TEUTA KRASNIQI, AKTORE, PREZANTUESE, KËNGËTARE, PROFESORESHË

Aktore, prezantuese, këngëtare, profesoreshë, janë vetëm disa nga profesionet e Teuta Krasniqi. Në të gjitha profesionet dhe projektet e saj ka treguar suksese të lakmueshme. Teuta Krasniqi është e diplomuar në degën e aktrimit. Ishte shumë aktive në pjesë teatrale dhe televizive. Ishte shumë e adhuruar me rolin e saj në "Kafeneja jonë".

Ka drejtuar edhe një numër të madh spektaklesh dhe koncerte të ndryshme. Gjatë karrierës së saj i ka realizuar edhe disa këngë, më shumë për qejfin e saj. Është edhe ligjëruese në Akademinë e Arteve.

Shkurt e shqip: shumë profesione, por shumë e talentuar.



JETON VORFI, MJEK, VALLTAR

"Art Desing", udhëhequr nga Jeton Vorfi, është themeluar në vitin 1995 në Gjakovë. Me vite të tëra e ka mbajtur epitelin e grupit më të mirë të vallëzimit jo vetëm në Kosovë, por në shqiptari në përgjithësi.

Por, Jetoni profesion parësor e ka mjekësinë. Është specialist i mjekësisë familjare.



Lendita Frroki dhe “VIP Nails & Beauty”, perandoria shqiptare e bukurisë në Zvicër

Lendita Frroki tashmë është emër i njohur në fushën e të bukurës. Ajo jeton dhe vepron në Aragau të Zvicrës. Qe 18 vjet merret me estetikë dhe ia ka dalë që sallonin e saj “VIP Nails & Beauty” ta bëjë të njohur, falë shërbimeve ekskluzive që ofron. Në ambientin e bukur, komod e relaksues, në “VIP Nails & Beauty”, kryhen një mori shërbimesh profesionale të fushës së estetikës dhe bukurisë. Pra, kush është Lendita Frroki dhe cila është jeta e saj profesionale e private?

Ju lutemi, na bëni një prezantim të vetvetes, edhe pse kemi dëgjuar se nuk të pëlqen të flasësh shumë në vetën e parë?

- Jetoj prej vitesh në Zvicër. Jam 40 vjeçe, bashkëshorte dhe nënë e lumtur e dy fëmijëve.

Merrem me bukurë dhe estetikë dhe kam biznesin, sallonin tim, ku ofrojmë një mori shërbimesh profesionale nga fusha e së bukurës dhe kontribuojmë që femrat të jenë më të kënaqura dhe më rehat me pamjen e tyre të jashtme.

Qe sa vjet merresh me këtë punë?

- Qe 18 vjet merrem me këtë punë. Punën e bëj me përkushtim, kor-

rektësi dhe me pasion e dashuri, sepse pa qenë të gjitha këto bashkë, vështirë arrihet suksesi.

Ku je shkolluar, aftësuar, profesionalizuar?

- Gjatë gjithë karrierës sime kam kryer shkollë, dhjetëra kurse dhe seminare të ndryshme, për të arritur në nivelin që jam. Jam angazhuar gjatë gjithë kohës për t'u avancuar më shumë e më mirë në këtë fushë.

Po biznesin, “VIP Nails & Beauty”, qe sa vjet e ke hapur?

- Para 12 vjetësh fillova të punoj në shtëpi, ndërkaj sallonin, tashmë të njohur, e kam hapur para katër vjetësh dhe ndodhet në Zentralstrasse 32 5610 Wohlen.

Cilat janë shërbimet që ofroni dhe çka u veçon nga të tjerët?

- Siç thash, në sallonin “VIP Nails & Beauty” ka shumë shërbime, duke filluar nga trajtimi profesional dhe zbukurimi i fytyrës me metodat Microneedling, Aqua Facial, Dermafazion, Radiorefequenz, etj. Pastaj, i rregullojmë thonjtë e duarve e të këmbëve, vetullat (vimpern) qerpikët, depilimin me laser, zbardhjen e dhëmbëve etj. Dhe, gjithsesi, të gjitha klientet tona dalin të kënaqura nga salloni ynë, meqë marrin atë që duan. Produktet tona janë lider në tregun ndërkombëtar.

Si është të jesh femër dhe të kesh biznesin tënd?

- Nuk them se është e lehtë, ama

kur e ke mbështetjen dhe ndihmën e familjes, nuk është edhe aq e rëndë dhe gjërat shkojnë më mirë.

A është vështirë të bëhet biznes në vend të huaj, në këtë rast në Zvicër?

- Ndoshta ka qenë dikur, por jo më. Falë Zotit ka shumë shqiptarë të suksesshëm në Zvicër, që e bëjnë në mënyrë të mrekullueshme punën e tyre.

Klientet tuaja janë të nacionaliteteve të ndryshme. Si e presin faktin se ti je shqiptare?

- Për to është me rëndësi ta bësh punën mirë, pa gabime, me korrektësi dhe rezultati final të jetë i kënaqshëm.

E, unë përpiqem ta arrij këtë dhe, fatmirësisht, deri më tash kam arritur suksese të lakmueshme.

Jeni edhe grua e bukur. A u ka ndihmuar bukuria të keni sukses më tepër?

- Shija është relative dhe secili është i bukur në sytë e dikujt. Njerëzit janë të bukur në forma të ndryshme. Por, pa dyshim, çdo femër e ka bukurinë e vet...

Cila është arma jote e fortë në profesion?

- Punoj me përkushtim, ashtu siç duhet. Por, mbi të gjitha, jam e singertë dhe mundohem t'i pres sa më mirë klientet.

Çka të ka ndihmuar më së shumti të jesh kjo që je?

- Fakti që nuk jam ndalur, jam munduar vazhdimisht. Por, pa dyshim, edhe mbështetja e familjes...

Çka konsideron si suksesin tënd më të madh?

- Familjen e shëndosh dhe fëmijët e mrekullueshëm. Pastaj vjen puna, biznesi dhe suksesi.

Veç këtyre që u thanë, a ke për të shtuar edhe diç tjetër për jetën tënde private?

- Si shumë shqiptarë të tjerë, edhe unë punoj dhe angazhohem shumë. Unë dhe burri i kemi punët tona, jemi mjaft të angazhuar dhe përpiqemi t'u sigurojmë një jetë sa më të mirë fëmijëve tanë.

Sa është sfiduese të jesh bashkëshorte, nënë dhe profesioniste, njëkohësisht?

- Nuk është edhe pa sfida puna që bëj, aq më tepër kur synoj t'i bëj të gjitha mirë. Dhe, për t'i arritur të gjitha lypset shumë vullnet.

Cila është lidhja jote me Kosovën dhe a ke menduar, ndonjëherë, për biznes në vendlindje?

- Vij çdo vit në Kosovë dhe lidhja, pa dyshim, është shumë e fortë, meqë Kosova është vendlindja ime, vendi që e dua shumë, e ku më pushon shpirti dhe ku i kam njerëzit e dashur.

E, sa i përket biznesit, momentalisht nuk kam ndonjë ambicie të hap biznes në Kosovë.

A je kuzhinierë e mirë dhe a di të përgatisësh ushqime tradicionale?

- Jam kuzhinierë e mirë. Edhe ushqimet tona tradicionale i përgatis me dëshirë të veçantë.


Cili është pasioni, hobi yt?

- Hobi im është shëtitja në bjeshkë. Më pëlqen të ecë në ajër të pastër dhe t'i shijoj bukuritë fantastike të bjeshkëve.

Për fund, një mesazh?

- Mesazhi im është për të gjitha femrat që duan të shkollohen dhe aftësohen sa më shumë, si dhe për të gjithë shqiptarët që të bashkohen e të punojnë me njëri-tjetrin, sepse vetëm kështu jemi më të fortë.

Nderim Neziri





Pse nuk kemi një muze të masakrave serbe në Kosovë?

Mungesa e një muzeu, që dëshmon krimet e luftës në Kosovë, rrezikon të lërë në harresë dëshmitë e gjalla, vrasjet, masakrat, keqtrajtimet dhe dhunimet që u bënë ndaj civilëve shqiptarë gjatë kohës së luftës.

Njerëz të fushës, si profesorë e historianë, thonë se mos-krijimi i një muzeu të tillë, përveç që tregon mos-respekt për sakrificën e të rënëve, rrezikon edhe kujtesën kolektive rreth ngjarjeve që tronditën vendin tonë dy dekada më parë.

Drejtori i Fondit për të Drejtën Hu-

manitare në Kosovë, Bekim Blakaj, thotë se mungesa e një muzeu që dëshmon krimet e luftës mund të krijojë problem në kujtesën kolektive. "Definitivisht, mungesa e një muzeu të përgjithshëm që kishte me trajtua të kaluarën, është një problem i madh, në rend të parë edhe në kujtesën kolektive tonën si shoqëri, ku edhe gjeneratat e reja do ta vizitonin dhe do të mësonin mbi të kaluarën. Mirëpo, është i rëndësishëm, gjithash-tu, për vizitorët apo turistët e huaj që vijnë në Kosovë, sepse pak ka të tillë që nuk e dinë se çka ka ndodhur në Kosovë. E, kur i interesohen se ku mund të mësojnë diçka më shumë për këtë luftë, në fakt, nuk ekziston një adresë e vetme", thotë Bekim Blakaj.

Ç'THOTË HISTORIANI MEMLI KRASNIQI?

Historiani Memli Krasniqi thotë se një muze i tillë është i rëndësishëm për të treguar krimet e kryera nga forcat serbe ndaj popullit të Kosovës. "Në një anë dëshmon për krimet serbe, në anën tjetër ndihmon në kujtesën kolektive të shqiptareve që mos

të harrohet, jo me qëllim që të mbjelët ndonjë ndjenjë e hakmarrjes, por jo edhe harresës, për të kujtuar dëmet dhe krimet e rënda që kanë ndodhur gjatë luftës në Kosovë...

E, çdo vonesë ose shtyrje e kohës deri në hapjen e muzeve ka pasoja, sepse shumë mbetje materiale ose janë shkatërruar ose nuk mund të gjenden, sepse veshmbathjet shkatërrohen, fotografitë mund të humbin, e edhe incizimet...

Por, me distancë kohore zbehet edhe kujtesa e personave që kanë jetuar ose mbijetuar masakrat...

PËR FUND

Institucionet shtetërore në Kosovë deri tani nuk e kanë pasur prioritetin e mbledhjen dhe dokumentimin e krimeve të luftës, të kryera nga forcat serbe gjatë periudhës 1998-1999. Kosova ka disa memoriale, të cilave, pa dyshim, u prinë ajo në Prekaz, ku dëshmohet sakrifica e familjes Jashari, por edhe ajo e Reçakut, e Mejes dhe disa të tjera, e që kërkojnë të mirëmbahen ashtu si duhet dhe si e meritojnë...

A DO TË MUND TË DUROJË SHPIRTI?

Vrasja e kohës është vetëm një emër, për mënyrën tjetër se si koha na vret neve...

RREZIKU

Nuk duket racionale përherë ta fajësojmë historinë, ta fajësojmë Evropën e botën për padrejtësitë ndaj kombit dhe popullit tonë. Këto fajësime nuk janë kontestuese. Po qe se vazhdojmë të merremi me vetveten, do të pranojmë logjikën vetërrënuese. Gjendja në të cilën jemi nuk mund të përballohet as lehtë e as shpejt pa bashkimin e forcave. Po qe se këtë nuk e bëjmë, do të ballafaqohemi me plasaritje dhe ndarje të reja. E, plasaritjet dhe ndarjet, populli dhe kombi shqiptar i ka paguar shumë shtrenjtë në të kaluarën. Kërcënohet rreziku që këto të tashmet t'i paguajmë edhe më shtrenjtë.

*

Me politikë duam të merremi të gjithë, edhe pse marrja me politikë kërkon një prirje të veçantë. Politika nuk është zeje që mësohet, por shkathtësi që lindë dhe zhvillohet.

*

Partitë tona të habitin: gabimet e partive të tjera i shohin, ndërsa gabimet e veta nuk i shohin! Partitë, të cilat për vetvete mendojnë se janë të pagabuara, gabojnë qysh në fillim. Koha po ecë...

Po ashtu, edhe mospajtimet po vazhdojnë dhe veç çka po ashpërsohen edhe më shumë.

XHAMI I THYER

Armiku me të cilin je pajtuar apo do të pajtohesh, zakonisht, nuk është më i mirë se një xham i thyer që është ngjitur, sepse fyerjet mbahen në mend më tepër se sjelljet e mira... Thonë: e mira harrohet, kurse e keqja ruhet me ngulm në kujtesë. E, kërkojnë të na pajtojnë me ata që na fyen, na bënë të keqe shekuj me radhë.

Por, sa kohë mund të shkojë që të harrohet e keqja e tyre?

Mund të harrojnë, mund të pajtohen vetëm ata që nuk kanë plagë. Kurrë ata që ende kanë dhembje, që ende plaga u kullon...

PRANVERË, KU?

Thonë se bashkë me stinët ndërrojnë edhe njerëzit. Edhe dashuria. Veli i gjallërimit fillon të mbulojë gjithë ç'gjen, ç'sheh... Edhe natyrën, edhe dashurinë, edhe kujtimin, edhe gëzimin, edhe lumturinë e shpirtave...

Epo, ç'i dhembë shpirtit? Ç'i dhembë në këtë pranverë?

Ndien nevojë t'ia qajë hallin dikujt, brengat, dashjet... Ndien nevojë t'ia çelë dikujt zemrën, ta lehtësojë veten. Me zemër të çelur, thonë, ndihesh më i lirë. Shkurt, ndihesh njeri...

Kudo, kah do e shikon pranverën, gjelbërimin...

Gjithçka kthehet në gjallëri, në ndjeshmëri...

Megjithatë, diçka mbetët edhe nga stina e ftohtë, s'harrohet dot, kujtohet...

Andaj, as në këtë pranverë s'dua që gjithçka e shkuar të harrohet, por as të kthehet, se në jetë ka edhe shumë dhembje dhe a do të mund t'i durojë shpirti?

*

Asgjë nuk mund të zgjatë përgjithmonë

As dhembja, as gëzimi

As dashuria, as pikëllimi

As jeta.

*

Thonë, njeriu është i ngjashëm me detin, të cilin askush nuk mund ta njohë, sepse të dy janë tinzarë dhe s'dihet çfarë kanë brenda.

Pra, njeriu dhe deti, dy fshehtësi të mëdha...

Gani Dili

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Dionita Sadrija

Gresa Mehmeti

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com



Kush po e sjellë Kosovën në gisht?

Te ne kudo ka probleme. Madje, problemet janë aq të mëdha, sa askush nuk mund t'ua gjejë fillin...

Te ne, në Kosovë, problemet jo që zvogëlohen, siç ndodhë në shtetet e botës demokratike, por sa vijnë e shtohen... Pse?

Sepse, a e dini sa njerëz janë bërë të pasur në Kosovë pasluftë?! Kur e kujtojnë se kush janë tash e kush kanë qenë dikur, ndalen para pasqyrës dhe e shikojnë veten: janë a s'janë ata...

GJITHÇKA MUND TË BËHESH VEÇ NJERI JO!

Për ta reflektuar këtë model psikologjik të njeriut se kush ishin e kush janë tash, është një batutë që mund ta dinë shumë njerëz, por që pak kund e kanë përdorur si duhet:

Një djalë hajlaz, në rini, nuk kishte lënë gjë të keqe pa bërë. Babai e qortonte çdo ditë dhe, më në fund, u lodhë së qortuari.

Një ditë i tha: "Ti kurrë nuk do bëhesh njeri, o bir!".

Por, ai nuk ia dëgjoi fjalët...

Atij, kur i erdhi koha e ushtrisë, veshi uniformën dhe fati deshi t'i ecte puna mirë. Dhe, si hajlaz që ishte, u bë oficer i lartë.

Kur u bë faktor, i urdhëroi disa ushtarë që t'ia sillnin babanë, ashtu qysh do e gjenin në shtëpi a fushë... Sepse, donte t'i tregonte se kush, në fakt, ishte ai, ku kishte arritur...

Shkuan nizamët dhe e morën me dhunë... Dhe, kur e sollën para tij, babai u ndal dhe e shikoi të birin e vet drejt në sy.

"A je ti, im bir?", e pyeti babai.

"Po, unë jam vetë!", ia ktheu ai. "Të kam thirr këtu për të të treguar se dikur më thoshe se kurrë nuk do bëhem njeri, prandaj shiko se kush jam unë sot!".

Babai e shikoi gjatë dhe i tha:

"Ti je bërë oficer, por nuk je bërë njeri! Unë ta kam thënë këtë të

fundit. Demek, nuk do bëhesh njeri, e jo nuk do bëhesh oficer”.

KUSH KE QENË E KUSH JE BËRË?

Dhe, duke e pasur në kokë këtë gjë, më zuri gjumi. Isha sorollatur aq shumë sa nuk i besoja vetes. Më kishin ardhur mu te koka e shtratit baballarët e shumë politikanëve tanë, që sot janë dikush dhe opinioni i njehë. Kishin kapur telefonat e vjetër dhe i thërrisnin bijtë e tyre. “Eh, kush je bërë ti e kush ke qenë! Je bërë i madh bir, je bërë i zoti, aq sa ta sjellësh në gisht Kosovën, por po të lëvizë gishti kohëve të fundit!”.

Vjen një baba tjetër dhe i thotë një deputeti, si në mjegull, se po flasim nga pozita e ëndrrës, të kup-tohemi dhe, sado që barazohet kjo me realitetin, dijeni se jam duke folur për ëndrra. Ai ia rrahë krahët

djalit të vet, duke i thënë:

“S’e kam pritur kurrë prej teje të jesh deputet!”.

“E, çka ke pritur tjetër nga unë, baba?!”, i drejtohet i biri.

“Kam pritur të jesh fermer”, i thotë babai.

A QITET GOMARI PARA DEVESE?

Vjen, pastaj, një babë tjetër, që djalë i tij ka qenë në luftë dhe tash nuk ia di skajin pasurisë dhe i thotë:

“Një pasanik, që ia dinte tregtisë mananë, merr karvanin me deve e gomarë dhe niset për në shehër. Qon atje çka kishte të qonte dhe merr çka kishte të merrte. Me t’u kthyer e devijon rrugën, meqë era kishte mbushur shtegun me rërë në shkretëtirë.

Disa kilometra pa hyrë në qytet, padronit, teksa drejtonte karvanin, i bie në mend se njërin prej

gomarëve e kishte blerë po në atë qytet. Dhe, duke menduar se gomari e njihte mirë terrenin, e vuri në krye të karvanit. Tash, që gomari i printe deveve, kjo e fundit u zu në siklet.

Dhe, për fat të keq, sëmuret padroni dhe mbetet në rrugë. Futet në një skutë hijeje dhe, duke menduar se çka kishte bërë keq që e gjeti e zezëdita, i shkoi mendja mos ishte ky dënim prej hakut të deveve që i kishte ngarkuar shumë dhe u afrua te njëra deve dhe i tha: “Oj deve, më jep hallallin, sepse nuk po mund të vdes pa ma dhënë!”.

“Për çdo ngarkesë që ma ke bërë ta bëj hallall, por për një gjë tjetër nuk ta bëj kurrë hallall!”.

“Çka?”, e pyeti padroni.

“Nuk ta bëj hallall kurrë kur ma vure gomarin para e unë ecja pas tij!”.

Sokol Murturi

Sa të tillë ka edhe në Kosovë?



Shqiptari që një javë fle me njëerën grua, një javë me tjetrën

Historia e Demë Mulës, 63-vjeçar, nga fshati Dobrun i Hasit, nuk është unikat, por është ndër historitë e rralla të shqiptarët. Ai jeton në të njëjtën shtëpi me dy gra. Pas gruas së parë, Hatixhes, e që nuk lindi fëmijë, Dema vendos të marrë një grua të dytë, Nazmijen. Por, as me atë nuk arriti të ketë fëmijë. Andaj, vendosi t’i mbajë të dyja.

Gratë e Demës shprehen se nuk kanë xhelozë ndaj njëra-tjetrës, madje bashkëshortin e tyre e ndajnë në mënyrë të barabartë, por që flenë në dhoma të ndara.

“Çifte si ne ka sa të duash dhe ne s’jemi as të parët e as të fundit”, thotë Hatixhja.

Ndërkaq, Dema shprehet:

“Ne, që i kemi nga dy gra, në Veri e kemi zakon një javë flemë me njëerën e një javë me tjetrën”.

Shtrohet pyetja: Sa çifte të tillë ka edhe në Kosovë dhe si e kalojnë jetën ata që jetojnë me nga dy gra?

Ç'tha nëna që djalin ia vranë para syve?

“Më vrisni edhe mua”, tha nëna që forcat serbe ia vranë djalin para syve, në Rezallë të Skenderajt...

Disa fëmijë të fshatit Rezallë të Skenderajt janë vranë gjatë luftës para syve të prindërve. Nëna e shkretë pa djalin e saj, Lulver Deliun, të vranë. Në ato momente ajo nga forcat serbe kërkoi ta vrisnin edhe atë. Momente të ngjashme përjetuan

edhe disa gra të tjera, të cilat ndodheshin aty, ditën e 3 prillit të vitit 1999. Një ndër fëmijët e vranë gjatë luftës ishte edhe Leutrimi, i biri i dëshmorit Malush Ahmeti.

Rrëfimi i nënës së tij për këtë ngjarje tragjike është tmerrues. Të afërmit e tij tregojnë se, veç Leutrimin, atë ditë ishin vranë edhe disa fëmijë të tjerë.

Emri i Leutrimin tash qëndron në murin e shkollës, që mban emrin e babait të tij, Malush Ahmeti.

Bashkë me të janë renditur edhe katër nxënës të tjerë të kësaj shkolle, që u vranë nga forcat serbe.

E, për nxënësit e tjerë, e që shpëtuuan nga vdekja, ishte shumë e rëndë asokohe, kur dëgjonin se shokët e shoqet e klasës po vriteshin.

Vetëm më 5 mars 1999, në Rezallë të Skenderajt, policia dhe ushtria serbe ekzekutuan 98 shqiptarë, banorë të Rezallës dhe të fshatrave përreth.



Portret: Fahrije Hoti

Gruaja e jashtëzakonshme

Më 25 mars 1999, fshati Krushë e Madhe e Rahovecit, ishte një dëshmitar i njëres prej tetë masakrave më të mëdha të Kosovës, ku gjatë tri ditëve sa zgjati masakra, paramilitarët, policët dhe ushtarët serbë vranë dhe masakruan 243 shqiptarë, e që 64 prej tyre ende janë të zhdukur.

Kjo masakër la 502 fëmijë pa një prindër dhe 140 gra të reja nën moshën 50-vjeçare.

Fahrije Hoti është një grua që mbart me vete të gjitha betejat e grave shqiptare. Gjatë luftës më 1999, ajo u dëbua nga fshati i saj. Në kthimin e saj, disa muaj më vonë, burri i saj ishte zhdukur dhe shtëpia e saj ishte djegur.

E ve, me dy fëmijë, ajo arriti, në solidaritet me gratë e tjera të fshatit, të çlirohet nga diktatet patriarkale të shoqërisë në të cilën jeton.

Duke qenë në krye të dy betejave, atë për kauzën e njerëzve të zhdukur gjatë luftës dhe atë për mbijetesën dhe pavarësinë e saj, Fahrije Hoti, së pari, krijoi organizatën joqeveritare “Të vejat e Krushës”, e cila do t'i bashkonte disa vite më vonë rreth gjashtëdhjetë gra në një kooperativë.

Dhe, duke punuar tokën dhe duke organizuar një biznes shembullor, të vejat e Krushës kanë arritur, falë forcës dhe punës së tyre, të mbështesin familjet e tyre.



Mediet kosovare janë vërshuar nga kronika të zeza: “Djali rrahë nënën”, “Djali vret babanë duke e shpëtuar nënën”, “Nëna e paraqet të birin në polici”, “Nusja e bën vjehrrën për spital”, “Burri vret gruan, pastaj vetveten!”, siç ndodhi rasti ditë më parë në Lagjen “Emshir” të Prishtinës etj.

Kosova në të kaluarën kurrë nuk ka lënguar nga ngjarje të tilla. Në vendin tonë ka pasur nder, fytyrë, mëshirë, e veçmas respekt ndaj prindërve. Kur isha fëmijë, ai që ishte qoftë edhe pak ditë para tjetrit, kishte të drejtë t'i kërkonte vëllait a shokut t'ia mbushte një gotë ujë. Fëmija nuk ka qenë kurrë adet t'ia kthejë fjalën prindit. E qonte në vend fjalën e prindit dhe s'kishte komente aty... E, tash? Askush askënd nuk e përshoshë!

NUK I KA RESPEKTUA PRINDËRIT, KA MBETUR I PARALIZUAR!

Para pak ditësh, në një ndejë, një kushëri i tregonte mikut se si vuan nga sëmundja daja i babait të tij: “E ka përfshirë sëmundja e keqe, qoftë larg nesh... Edhe trupi i është tharë, sepse ka mbetur qe sa vjet ratë. I kanë blerë djemtë shtrat enkas për të sëmurët e tillë, por nuk po i ndihmon. Nuk mund të fle. Flet pa lidhje dhe nuk dinë çka të bëjnë me të. Dikush u kishte thënë sakrifkoni një kur-

ban dhe ai do të drejtohet në njërrën rrugë... Edhe kurbanin e kishin ther por kot...

Por, si i ri nuk kishte qenë i rehatshëm. Kurrë nuk kishte ditur me nderua babë e nënë! Nuk kishte bërë asgjë të mirë për askënd, prandaj Zoti e ka dënuar me vuajtje...”

Dhe, tek i dëgjoja kah flisnin, mendja mu kthye në fëmijëri të hershme, kur halla tregonte në odë si kishte vdekur babai i saj.

“Baba, pak para se të vdiste, kishte kërkuar ta nxirrnin jashtë, nën hijen e “Dardhës Ukere”. Dhe, qysh kemi qenë tu ndenjor, baba më tha:

“Qohu Resime, më shti brenda se më ka ardhur iza me vdekuri!”

“Jo, babë, qysh vdesë kaq i fortë ti?! Edhe pse u je afruar të 100-tave, ende sheh më mirë se unë!”, i thashë.

“Qohu se unë u hallashtisa me dardhën dhe me të gjithë ju”, ma ktheu paksa me zë të shterur dhe shtoi: “A e di ti pse po vdes kështu, kollaj? Tanë jetën time i kam ndihmuar të tjerët sa ka mundur dhe pa prituar fare. I kam rritë tre breza jetimë. 12 vjet i ka mbajtur burg në Turqi në kohën e

turkut! Pra, këto tri sende më bëjnë të jap shpirt lehtë...”

DIKUR S’KISHTE MJEK, POR AS SËMUNDJE SI TASH!

Dikur nuk ka pasur mjekësi si tash, por nuk ka pasur as sëmundje e vuajtje. Sot, me gjithë këtë mjekësi të zhvilluar, njerëzit vdesin duke e trishtuar rrethin dhe ambientin e vet.

Njerëzit vdesin në fatkeqësi të rënda, në gjëra që nuk paramendohen dhe krejt kjo ndodh, siç kanë thënë të vjetrit, “kur bota bëhet haraba”!

E, çka do të thotë “haraba”? Haraba do të thotë kur njerëzit shkatërrohen, duke mos respektuar askush askënd dhe duke u bërë kanibalë ndaj species së vet gjenetike!

Gjithashtu, njerëzit i përfillnin amanetet pas vdekjes. Njerëzit shkonin në haxh edhe për të vdekurin nëse ai e kishte lënë amanet, e që nuk kishte pasur mundësi të shkonte në kohën sa ishte gjallë.

E, kjo për atë kohë ishte interesante...

S. Krivaça



Shkonin në haxh edhe për të vdekurin!



Gjysh, a ti ke për t'më rritur mua, a?!

Pse e desha shumë nipin e porsalindur? E mora në krahë, me të dalë nga dera e spitalit të lindjes. Ia vura mindilin mbi fytyrën e bardhë si bora maje mali.

Gruaja më mbështetej gjatë ecjes dhe herë-herë mendohej t'ia shihte fytyrën e vockël. Unë mendoheja ta mbaja gëzim brenda vetes, në shpirt dhe të mos e hetonin të tjerët...

Ishte një lloj gëzimi, sikur e shprehin edhe lojtarët në fushë kur shënojnë gol dhe ikin në një qosh të fushës që ta përjetojnë atë gëzim vetë, sepse po të qëndrojnë afër të tjerëve ata do i hedhen sipëri dhe do e zënë për fundi...

SI FOLI FOSH NJA E PORSALINDUR?

Kur arritëm te banesa, në hyrje, teksa e prisnim ashensorin, foshnja që kisha në dorë foli. Lëshoi një zë, si të ishte fëmijë i rritur.

Unë ia ktheva përgjigjen. Por, kur më dëgjoi gruaja që foli, u habit me kë foli, sepse nuk ishte askush afër...

"Me kë fole?", më pyeti gruaja dhe nuk u ndal me kaq: "Je bërë si Sahit Fyelli, ke filluar të flasësh me vete! Mos u gëzo shumë se nuk është mirë!".

"Si të mos gëzohem, grua?! Ç'nip të shëndoshë na fali Zoti... Nuk e donim në fillim nënën e foshnjës, por, me kohë, gjërat ndryshuan", ia ktheva.

Dhe, sapo hymë në banesë, gruaja m'i bëri disa pyetje, duke më përberë me kë foli teksa ishim duke e pritur ashensorin.

"Fola me nipin. E foli një fjalë, e unë ia ktheva përgjigjen", i thashë.

Por, nuk më kishte shkuar assesi në mend se ai zë fëmije kishte ardhur nga ata që ishin në ashensor, kurse mua m'u bë se foli foshnja...

"Nejse, kanë nisur me të bërë veshët zhurmël", më thotë gruaja.

Por, as atë ditë e as sot nuk e kam të qartë se si nga foshnja doli një fjalë...

GJYSH, A TI KE ME MË RRITUR MUA, A?!

Tash kanë kaluar gjashtë vjet nga ajo ndodhi, kurse ai në fytyrë ende është i bardhë si bora. Por, për fat të keq, prindërit e tij nuk janë rehatuar në jetën bashkëshortore dhe nipi im i dashur jetën e kalon sa te njëri prind sa te tjetri...

Ai sikur e ka kuptuar se shumëçka nuk është në rregull me prindërit e tij: Nuk qeshë, nuk ka entuziazëm dhe pa dëshirë shkon në shkollë...

Dje më telefonoi dhe më tha të shkoja ta merrja në shkollë. Do të fle në shtrat me mua, sepse gjithmonë i tregoj ndonjë përrallë...

Por, para se ta zinte gjumi më bëri një pyetje, e që ishte shumë e rëndë për mua: "Gjysh, a ti ke për të më rritur mua, a?!".

S. Krivaça

Nuk e kam ditur se burri im është Donzhuan!

E gjeta ditarin e burrit tim në një kuti derisa po pastroja dollapët dhe, fatkeqësisht, zbulova se ai ka pasur disa afëra, e që ma ngritën tensionin...

Jam 52-vjeçare. Jam martuar me tim burrë para 25 vjetësh dhe asnjëherë nuk më ka shkuar mendja se burri im mban sekrete, të cilat e sollën martesën tonë në pikëpyetje.

Si ndodhi kjo?

E gjeta ditarin e burrit tim në një kuti derisa po pastroja dollapët dhe, fatkeqësisht, zbulova se ai qëmoti më tradhtonte! Më pas e shikova telefonin e tij, kur ai ishte jashtë, dhe i gjeta me-

sazhet e një femre vetëm disa ditë më parë.

AH, AI DITAR I MALLKUAR!

U ndjeva e copëtuar kur e lexova ditarin, isha e shokuar dhe në mosbesim. Ai kishte shkruar me detaje se si ishte njohur me ato femra dhe çfarë kishte bërë me to. E gjithë bota ime u shembë në ato momente...

Një ditë, teksa ai lahej, telefonin e kishte lënë mbi televizor. Ai kishte një kod dhe nuk hapej dot. Por, kureshtja se çka i shkruanin të dashurat, më nxiti që me çdo kusht ta zhblllokoja. Dhe, kur u hapë telefoni, një mesazh ishte ende i pahapur. "A do të takohemi sot pas pune?", shkruante.

Dhe, nuk di as vetë se ku e gjeta kurajën, po e thirra atë numër. Kur i tregova asaj gruajë se kush isha, ajo nuk e mohoi, por më tha se me

tim burrë është në lidhje dashurie që një vit. Asaj nuk i interesonte se unë isha e mërzitur, se bota ishte rrokullisur për mua...

DIGJE DITARIN PO TË DUASH!

Po atë ditë, në mbrëmje, kur im burrë u kthye nga puna, i thashë se në telefonin e tij e kam parë një mesazh të një femre me të cilin është në lidhje.

Për çudi, nuk u befasua, siç e prisja nga ai. Uli kokën në shenjë pendimi dhe zë nga goja nuk nxori... Dikur, pas një heshtjeje të gjatë më tha: "I kam përfunduar të gjitha aferat! Tash ai ditar nuk paraqet asgjë për mua. Digje po të duash". Por, nga ajo ditë e deri më tash, zemra ime është e thyer se si ka mundur të ma bëjë këtë ai. E dua, por nuk di a do të mund ta kaloj ndonjëherë këtë lëmsh që e kam në shpirt...

E. Th.



Pak fjalë për burrat “e moralshëm” kosovarë, që skuqen në fytyrë si speci i kuq kur të përmendet fjala “seks” dhe femrat e “moralshme” kosovare, që shiten “namuzlike”, por që fshehurazi janë në gjendje të bëjnë gjithçka po nuk i pa kush...

Një temë që është lënë anash në Kosovë, por që vlon si “tamli në zjarr” është morali. Sepse, kosovarët, edhe në vitin 2021, sikur preokupohen me patriotizëm dhe me çështje të identitetit shtetëror, e veçmas me fushatat zgjedhore, e që janë me bollëk në Kosovë. Kështu, vetëm bisedat e fshehta që bëhen ndërmjet “burrave” dhe femrave “namuzlike”, alias femrave që shiten të moralshme, janë tema “të moralit”.

A ka deputet në Kosovë që flet haptazi për moralin?

Pse në këtë shkrim do të bëjmë fjalë vetëm për moralin e burrave dhe të grave nga Kosova? E para, sepse nuk e njoh mirë këtë çështje në Shqipëri dhe, e dyta, sepse mendoj se niveli i komunikimit për moralin në Shqipëri është në një shkallë më të lartë dhe se Shqipëria mendoj se i ka kaluar kufijtë e provincializmit kosovar.

SA HERË QË FLITET PËR MORAL NË KOSOVË, FLITET PËR GJËRA TË PAMORALSHME!

Në të vërtetë, për moralin në Kosovë flitet në gjuhën më të pamoralshme. Janë të rrallë ata

meshkuj që janë 20, 30, 40 a 50-vjeçar, që në bisedat e ngushta miqësore, të mos krekosen për “biografi” të tyre të pasur seksuale, duke përmendur numër të pacaktuar të femrave që i kanë “rrëzuar përtokë”... Dhe, të tillët, e që nuk janë të paktë, po ashtu, në çdo kohë, janë të gatshëm t’i gënjejnë e tradhetojnë me arsyetimet më banale të dashurat, të fejuarat apo edhe gratë e tyre për një “copë mishi të bardhë”...

LIRIA SEKSUALE FRANCEZE...

Vetëm 500 metra larg selisë së Këshillit të Evropës në Strasbourg, në rrugën kryesore të këtij

kryeqyteti parlamentar evropian, kur bie terri i natës, fillon shëtitja e lirë e femrave që ofrojnë kënaqësi seksuale.

Sigurisht, tash është më ndryshe, duke u ruajtur në masë të madhe nga pandemia...

Ato shëtisin në rrugë, në kërkim të ndonjë klienti apo qëndrojnë në vendet e caktuara, ku klientët ndalojnë veturën apo ofrohen për t'u marrë vesh për "çmimin", "ofertën".

Sepse, seksi në Francë është i lirë, kurse ndalohet vetëm seksi në rrugë.

NJË LIGJ QË MUNGON NË KOSOVË

Dhe, t'i kthehemi pyetjes që shtruum në fillim të këtij debati: A është debati për moralin temë e ndaluar?

Pra, vetë fakti se nuk debatohet haptas, nuk do të thotë se jemi shoqëri e moralshme. Ndërkaq,

krekosjet e burrave kosovarë për biografi të pasur seksuale, të krijon bindjen se nuk ka mbetur femër e virgjër në Kosovë!

Për moralin apo edhe dukuritë amoralë pak shkruhet në mediet tona, apo në nivele të tjera komunikimi...

Në Kuvendin e Kosovës asnjë deputet s'ka propozuar asnjëherë një ligj që do e rregullonte çështjen e lirisë seksuale në Kosovë!

B. M.

Flash



Nuk u shkoji zëri, *por u bën të famshme!*

Jo të gjitha motrat kanë mundur të bëhen këngëtare, ama të famshme janë bërë gjithsesi. Bie fjala, Nita e Nora dhe Era Istrefit.

Gjithashtu, e njohur, falë motrës, është bërë edhe Uendi, motra e Encës.

E, në këtë renditje hyn edhe Mani, motra e Genta Ismajlit,

që gëzon famë në shpinë të së motrës.

Por, nuk përjashtohet as Jehona Dreshaj, që duhet t'i falënderohet Afërditës, por edhe gjoksit që ka.

Vetura pa regjistrim si në kohën e pasluftës!

Letrat dhe bërlloku na ngulfatin kudo, e ne nuk kemi letër për letërnjoftim dhe teneqe për targa regjistrimi! Kjo më ktheu me mendje në kohën kur u kthyem në Kosovë, menjëherë pas lufte, kur rrugëve kudo hasje në vetura pa regjistrim...

Ditëve të fundit shoh vetura me targa PR (probatin). Habitem, sepse nuk më ka shkuar mendja se shteti ka mbetur pa tabela automjetesh. E di se disa herë kanë mbetur pa material për letërnjoftim, për pasaporta e patentë-shoferë, por që s'ka targa të veturave këtë s'ma kapë mendja!

Në lagjen "Mati 1" shoh edhe më keq. Një xhip, "X6", del para meje në rrethin me disa hyrje e dalje barrierash rrugore nga plastika, e që janë një lloj pengese të mbahet rendi brenda rrethit. Dhe, xhipi nuk ka tabela fare!

Po atë ditë shoh edhe një tjetër veturë pa tabela, pastaj edhe një tjetër e kështu me radhë...

I habitur me atë që pashë, desha të kthjellem për pak çaste, duke parë një ambient të ngjashëm me vitin e largët 1999, kur, pas një

qëndrimi 3 muajsh në Shqipëri, po kthehesha në vendlindje, kur ende kishte serbë me uniforma, por edhe vetura pa tabela regjistrimi... Ngjashëm me atë kohë sot ndodh në veriun e Kosovës, ku kudo shihen vetura pa regjistrim...

Shtrohet pyetja: Pse ndodh kjo? Si është e mundur të mos ketë teneqe për tabela, kur vetes i themi shtet qe 20 vjet?!

A pak shtypshkronja ka në Kosovë dhe nuk janë në gjendje të shtypin materialin e nevojshëm për letërnjoftim e patentë-shoferë?!

Dhe, si shtet nuk prodhojmë asgjë, kurse krekosemi se e kemi shtetin tonë dhe ai po funksionin si duhet! Pra, fjala është për një shtet që nuk prodhon as targa të regjistrimit për automjete e as material për letërnjoftim e patentë-shoferë!

S. M.

BOOM

*Linda,
nga "Beauty's Linda",
i zbukuron të gjitha*

Si u bë
Dafina Zeqiri yll?

Elvana Gjata e humbi
armën e fortë
që e kishte!

Nipi i Enver Hoxhës
ngrohu zemrën
e bukuroshes...

Dobësohuni me dietën
e Flori Mumajesit...

Cilat janë armët e këngëtareve tona?

Dikush ecë përpara me talent, me guxim, e dikush me të pasme...

Pra, vlen të kesh diçka dhe më pas rruga është shumë e lehtë...



SI U BË DAFINA ZEQRIRI YLL?

Në skenën muzikore shqiptare ka pasur dhe ka këngëtare të talentuara, që kanë habitur me potencë vokale, por rrallë na janë shfaqur para syve vajza me talent dhe stil avangard si i Dafinës.

Dafina Zeqiri, që në start, tregoi zëshëm se dëshiron t'i thyej disa tabu, rregulla e klishe. Paraqitja "ndryshe", menjëherë, e kategorizoi në rangun e

artisteve kreative.

Ajo që në fillim dukej si divat botërore. U paragjykua, por kjo nuk i bëri për-shtypje...


Edhe sot thuhet se është njëra nga këngëtalet më të influencuara nga yjet botërore. Por, përkundër kësaj, Dafina "shet" me stil.

Së fundi, Dafina ka lansuar këngën me titull "Duro".

PËR TUNËN VLEN THËNIA "KU RAFSHA MOS U VRAFSHA!"

E talentuar, me stil, por edhe eksplicite. Gjuha e saj e mprehtë ka bërë që Tuna të pikaset. Ajo nuk e ka problem të flasë, të thotë çka ndjen. Por, edhe kur nuk i shkon në dashuri a martesë, ndahet pa problem.

E, ky është guxim, apo jo?!



ELVANA GJATA E HUMBI ARMËN E FORTË QË E KISHTE!

Elvana Gjata, pa dyshim, di të këndojë, por jo më mirë se këngëtalet tjera, me të cilat ke garuar te shou i talenteve "Ethet e së premtes mbrëma", të cilët e kanë lënë prapa në garë Elvanën, por që sot nuk janë askund.

Ndërkohë, Elvana ka arritur lart, bile në majën e këngëtareve produktive, atraktive dhe të paguara. Bukuroshen e ka ndihmuar fuqishëm një person: Flori Mumajesi. Megjithatë, Elvana viteve të fundit i ka ndarë rrugët me Florin, për çka edhe karriera e saj ka pësuar rënie...

N.



Cilin ekip të futbollit e pëlqen Fatmir Spahiu?

Fatmir Spahiu, i njohur si “Oki” i “Kafensë...”, vërehet se nuk i ka punët mirë me sport, por kjo nuk do të thotë se ai nuk e pëlqen atë.

Nuk preferon të merret vetë me sport, por ndeshjet në televizor i shikon me qejf. Mësojmë se aktori është adhurues i flaktë i futbollit, ndërkaq ekipi i tij favorit është “Chelsea”.

Madje, me këtë dashuri e ka “infektuar” edhe djalin e vet, i cili tani është bërë një fans i madh i ekipit që e preferon babai i tij.

Jeta e lumtur e Lorik Canës

A është Loriku dashuria e parë e Monikës?

Ish-kapiteni i kombëtares shqiptare, Lorik Cana, që disa vjet është i martuar me arkitekten italiane Monikën.

Loriku e Monika janë ndër çiftet më të dashur dhe më të njohur të shou-bizit shqiptar.

Një adhurues i çiftit i është drejtuar Monikës me një pyetje shumë interesante: “A është Loriku dashuria jote e parë?”.

Ajo thotë:

“Kur je e vogël mendon se ke gjetur dashurinë. Por, më pas rritesh dhe vetëm kur gjen mashkullin me të cilin do të ndërtosh familjen, pa të cilin nuk e imagjinon dot të jetosh as edhe një ditë, sepse të mungon fryma, vetëm atëherë e ke gjetur dashurinë e parë dhe të vetme”.

Pra, a qenka Loriku dashuria e parë e Monikës a jo, ua lëmë ta vlerësoni ju vetë, lexues të dashur...





Nipi i Enver Hoxhës ngrohu zemrën e bukuroshes...

Këngëtarja e njohur, Rrezarta Shkurta, njihet si natyrë ambicioze. Ajo edhe e arriti suksesin me çdo kusht. Edhe vetë tregon se kur ishte e re donte me, patjetër, të bënte karrierë dhe të njihej nga të gjithë.

“Kur e arrita moshën e pjekurisë, përafërsisht 18 vjet, mendoja se asgjë në botë nuk do kishte më rëndësi dhe nuk do më bënte më të lumtur se karriera”, thotë këngëtarja, që për të bërë famë e sfidoi veten disa herë. Fillimisht, u shfaqë si modele, më pas këngëtare dhe në fund fotografe. “Kur isha e re i kisha disa synime, që më rrinin tërë kohën në kokë. Por, sa më shumë që ngjisja shkallët, aq më shumë bëhesha e pangopur dhe e palumtur”, shprehet ajo dhe shton se lumturinë e vërtetë nuk ia solli sukcesi e as paratë, por një person i veçantë.

Cili?

“Me kohë kuptova se asgjë nuk mund të arrijë të të bëjë të lumtur pos atij që ta do zemra. Mua ma ndryshoi jetën dhe ma ngrohu shpirtin vetëm ai, tash burri im, Ermali”, ka thënë në fund këngëtarja, e cila duket se po jeton martesë të lumtur.



Linda, nga “Beauty’s Linda”, i zbukuron të gjitha

*“Kosovarja”
është gjithmonë
në kërkim të his-
torive të suksesit.
Bota e femrës
është e madhe,
e pasur dhe me
shumë ngjyra.
E tillë është edhe
bota e Lindës,
personazhit
për të cilën na
folën disa herë
bashkëpunëtorët
tanë, duke
treguar se sa e
veçantë është në
personalitet dhe
profesion.
E gjetëm dhe ja
ku e kemi...*



E BUKUR, E ZONJA, E SUKSESSHME

Arlinda Rexhepi-Bajrami është me prejardhje nga Kosova, por e lindur dhe e rritur në Gjermani. Është e bukur dhe punon për të bukurën. Të gjithë e njohin si Linda e "Linda's Beauty", salloni të njohur në Sindelfingen të Gjermanisë, qytet afër Shtutgartit, e ku gjendet edhe fabrika e "Mercedesit", për çka ky vend edhe është mjaft i njohur. Linda nuk dëshiron të flasë shumë për vetën e sukseset e saj, pasi beson se për të flet puna dhe rezultatet ndër vite.

"Qysh në fëmijëri më ka pëlqyer bota e së bukurës, e kam pasur pasion dhe e dua shumë. Pas shkollimit, vendosa të merrem me këtë punë dhe më ka ecur mirë", thotë Linda, e cila për disa vite ka punuar për "Dior", ndërkohë që pesë vjet, bashkë me shoqen e saj Yale Yaman, kanë hapur sallonin e tyre të bukurisë.

Në "Linda's Beauty" të gjitha shërbimet realizohen në mënyrë të perfeksionuar, duke u nisur nga Microblading, Microneedling, Mesoporation, Microdermabrasion, Lifting Pen, Ultraschall Lifting, si dhe Make up. Salloni është ekskluziv dhe i nivelit të

lartë, kurse klientet janë të të gjitha nacionaliteteve. Madje, ka edhe shumë emra të njohur si nga arti, shou-bizi, politika dhe të tjerë me famë, e që e vizitojnë për të përfutur shërbimet profesionale të "Linda's Beauty". Influencerja shumë e njohur në "Instagram", Kimberly Sowles, i shkruan me admirim Lindës për punën e shkëlqyeshme që bën ajo... Linda punon edhe me "Branko Babic Akademie", ku mban seminare dhe, gjithashtu, bashkëpunon me firmën e njohur të kozmetikës "Dalton Kosmetik". Ndërkohë, kuptojmë se ka bashkëpunuar me disa sallone në Kosovë, ku u ka dhënë kurse për Microneedling dhe BB Glow. Por, krahas punës dhe angazhimeve të përditshme, Linda gjen kohë edhe për veten dhe hobi të saj. "Pa dyshim, duhet të kemi kohë edhe për veten, ani pse shpesh puna e madhe arrin të na largojë paksa nga vetja. Hobi kam udhëtimin dhe përpqem të udhëtoj sa më shpesh dhe në vende të ndryshme, meqë kështu edhe e realizoj një prej pasioneve të mia. Por, më pëlqen edhe sporti..."

Nderim Neziri



Dobësohuni me dietën e Flori Mumajesit...

Flori herë pas herë mbanë dietë javore, bazuar në një meny ku dominojnë proteinat, dietë kjo e marrë nga Instituti Gjerman i Shëndetit. Meqë tash jemi në fillim të pranverës dhe vera nuk është larg, ua propozojmë dietën e Florit, që të përgatiteni për ditët e nxehta që do të vijnë...



DITA E PARË

Mëngjesi: Qumësht ose kafe pa sheqer dhe një fetë bukë e thekur.

Dreka: Dy vezë të ziera dhe spinaq pa kripë.

Darka: Biftek i madh (në grill) dhe çdo lloj frute.

DITA E DYTË

Mëngjesi: Qumësht ose kafe pa sheqer dhe një fetë bukë e thekur.

Dreka: Biftek i mesëm (në grill), sallatë dhe çdo lloj frute.

Darka: Mish i bardhë në sasi të limituar.

DITA E TRETË

Mëngjesi: Qumësht ose kafe pa sheqer dhe një fetë bukë e thekur.

Dreka: Dy vezë të ziera, plus sallatë me domate.

Darka: Mish i bardhë dhe sallatë.

DITA E KATËRT

Mëngjesi: Qumësht ose kafe pa sheqer dhe një fetë bukë e thekur.

Dreka: Një vezë e zier, karota dhe djathë i bardhë.

Darka: Kos, plus fruta të freskëta.

DITA E PESTË

Mëngjesi: Karota të grira me limon.

Dreka: Peshk në avull dhe dy domate.

Darka: Biftek i madh (në grill).

DITA E GJASHTË

Mëngjesi: Qumësht ose kafe pa sheqer dhe një fetë bukë e thekur.

Dreka: ½ pulë e pjekur.

Darka: 2 vezë të ziera dhe karota të grira.

*Në këtë vend të
mallkuar, siç kishte
thënë Nastradin
Hoxha, për shumë
njerëz te ne, në
Kosovë, mjerisht,
jeta ka nisur pas
luftës së vitit 1999!
E habitshme, a?!*

AKSIDENTI I DJALOSHIT TË HASRETIT...

Një djalë në lagjen time, djalit
e axhës Lutë, e donin të gjithë.
Axha Lutë kishte shumë vajza dhe
vetëm një djalë.
Djalit i vënin në flokë rruaza të kal-
tra, që të mos i binin mësysh. Por,
si fëmijë i vogël, rruazat nuk i du-
ronte dot mbi flokë dhe i këpuste.
E, posa i këpuste sëmurej...
Prindërit përsëri i vënin rruaza mbi
flokë... Dhe, kur u rritë, më nuk
barte rruaza për mësysh.
Por, teksa kalon rrugën në
magjistralen Shkup-Prishtinë, e
goditë një veturë, e që pas pak
ditësh edhe vdesë. U bë vaj i
madh jo vetëm në shtëpinë e ax-
hës Lutë, por edhe në tërë lagjen
tonë...
Dhe, koha ecte... Vajzat u martuan,
prindërit vdiqën, shtëpia u rrënu
vetvetiu dhe mbeti oborri nën
mëshirën e një mallkimi të mësysh-
hit, që ishte hequr nga floku...
Sikur t'i kishte mbajtur rruazat mbi
flokë, thoshin, ai nuk do të vdiste...

ADA VDIQ NË DITËN E MARTESËS!

Një vajzë të bukur në mëhallën
tonë e quanin Ada. Ishte e bardhë
si bora. Nëna e saj i jepte qumësht
me borë! Donte t'ia skuqte faqet
vajzës, sepse ishte tepër e bardhë.
Kur u bë për martesë e kërkonin
nga shumë familje. I vinin mesitët
çdo ditë dhe, më në fund, e fejuan




Si ndodhën dy vdekje nga Syri i keq?

dhe së shpejti do të bëhej nuse.
Gratë thoshin se nëse do martohej
në kohën e Shëngjergjit, zor që do
i shpëtonte syrit të keq...
Ashtu edhe ndodhi. Ajo u martua
po në atë kohë...

Siç ishte adet, vinin gra e miq ta
uronin në shtëpi, por një grua nuk
ia ndante sytë...
Dhe, pas dy ditësh, u sëmure dhe
rrugës për në spital vdes...

S.

Vendimi më i vështirë për të rinjtë e sotëm duket se është ai për martesë. Viteve të fundit vihet re një shtyrje e kufijve kohorë në moshë për krijimin e institucionit më të rëndësishëm, siç është familja. Studimet, gjetja e një pune, përpjekja e të pasurit një karrierë të suksesshme dhe krijimi i bazës financiare, janë vetëm disa nga arsyet kryesore, të cilat bëjnë që të rinjtë, kryesisht femrat shqiptare, ta largojnë vëmendjen nga përfshirja serioze në një marrëdhënie si ajo familjare.



Cila është mosha ideale për të krijuar familje?

Në anketën e bërë me të rinj, pjesa më e madhe e femrave të intervistuar na e pohojnë këtë fakt. Por, ka edhe nga ato që mbrojnë anën tjetër të medaljes: një martesë në moshë të re ka të tjera të mira, të cilat ndikojnë në raportin prind-fëmijë, duke zvogëluar largësinë kohore mes tyre e për pasojë edhe mosmarrëveshjen mes brezave.

MARTESA NË MOSHËN 27 E 28 VJEÇ ËSHTË IDEALE
Mendimi i të rinjve është se mosha 27-28 vjeçe është moshë ideale për

të krijuar familje. Duke menduar që individit e ka përcaktuar dhe e ka nisur tashmë karrierën e vet, është stabilizuar në një punë, e që te ne në Kosovë ajo shumë vështirë sigurohet, si dhe ka kaluar edhe përvojat e veta jetësore, është gati për të krijuar familje.

E, sa i përket momentit të përshatshëm të ardhjes në jetë të një fëmije, nga të anketuarit del se mosha ideale për një gjë të tillë është rreth të 30-ave, sepse në këtë moshë femra është më e pjekur.

Ç'THOTË AGNESA BEQIRI, NGA FERIZAJ?

"Jam 28 vjeçe dhe mendoj se jam në kohën ideale për ta zgjeruar familjen, kështu që po i qëndroj mendimit tim duke e provuar me vepra".

Agnesa shprehet skeptike sa i përket marrjes së këtij vendimi nga të rinjtë sot.

"Sot të rinjtë sikur kanë frikë nga angazhimet", thotë shkurt ajo.

Ç'THOTË MIRANDA KRASNIQI, NGA PRIZRENI?

Miranda është 32 vjeçe, nënë e një fëmije. E martuar në moshë relativisht të re, ajo tregon se jo domosdoshmërisht moshë është thelbësore në krijimin e një familjeje.

"Mendoj se krijimi i një familjeje lidhet me ndjesinë, atëherë kur mendon që ke gjetur personin e duhur dhe ndihesh e sigurt në atë që përjeton me të. Unë jam 32 vjeçe, e kam një fëmijë dhe familjen time e kam nisur në një moshë relativisht të re. Në moshën 19 vjeçe jam fejuar, kurse 20 vjeçe u martova. Andaj, krijimi i një familjeje me kohë i ka dhe të mirat e veta", shprehet ajo.

Ç'THONË EKSPERTËT?

Sidoqoftë, ekspertët që merren me planifikim familjar mendojnë se martesë nuk është vetëm bashkim biologjik, por është institucioni kryesor i jetës private dhe krijimi i saj është një çështje individuale e atyre që e krijojnë atë.

Prandaj, se kur të rinjtë duhet të krijojnë familje, nuk ka një kohë të caktuar, por mbetet në vullnetin e atyre që dashurojnë...

Diturie Haxhaj



E talentuar, në formë...

Albërie Hadërgjonaj ende "adoleshente"

Këngëtarja Albërie Hadërgjonaj njihet për martesën e saj në moshë shumë të re. Ajo nuk ka ngurruar asnjëherë të tregojë se është martuar shumë e re dhe ka vite e vite që jeton vetëm, pa jetë bashkëshortore.

"Jam martuar e re dhe tani po e shijoj adoleshencën", shpeshherë ka thënë ajo.

Si një grua që u martua në moshë të re, ka një këshillë për vajzat:

"Kam qenë e re dhe e kam përjetuar vetë, vajzat duan kohë të

rriten dhe të emancipohen, nuk kanë pse të nxitojnë...".

Asaj nuk i bënë përshtypje pse me foto të ndryshme provokuese u bënë konkurrencë edhe vajzave të reja, sepse Zoti ia ka falur bukurinë, përmasat e mira trupore, e veçmas zërin, me të cilin nuk pushon kurrë së bëri këngë që gjithmonë janë hite...

Projekti i saj i fundit është "1 shans". Dhe, me siguri, nuk do të jetë i fundit, meqë është më në formë se asnjëherë...

Shoh ëndrra që hapi varre. Pse?!

*Para ca netësh
pashë ëndërr
duke hapur
varre. Mezi
shpëtova nga
tmerri... Dhe,
nga ajo natë
më nuk dua të
shoh ëndrra!*

Një natë më ndodhi diçka që kisha dëshirë të ishte ëndërr, por ishte realitet. Sepse, njeriut nuk i bie kurrë tamam, mendoj me vete.

Dy zonja më prisnin në fund të arës. Aty shtrihej livadhi me lule të verdha, e që si fëmijë i quanim "pipiria". Bletët dhe fluturat ishin me bollëk dhe vinin e shkonin para syve, duke ma prerë rrugën.

Shumë vite më parë, një

burrë, e që kishte punuar në Zvicër rreth katër dekada, kishte pësuar aksident në Slloveni, teksa shkonte për në Zvicër.

Kurimi në Zvicër kishte përfunduar me shumë proteza ari: një në kurriz, dy në njërën këmbë dhe një në njërën dorë.

Pas disa vjetësh ai kishte vdekur dhe flitej se ishte varrosur me të gjitha elementet e arit që i përmendëm.

Rreth meje kalonte një kamionetë, mbushur me lopata e mjete për mihje. Tre burra ndodheshin në kamionetë dhe ma bën me shenjë që të hipja edhe unë në të... Por, nuk dija se ku shkonim...

MË KISHTE HUMBUR BILETA DHE NUK DIJA PËR KU ISHA NISUR!

Isha pa cak, siç shkruan edhe Çehovi në kujtimet e tij, kur ishte nisur për në një qytet, e nuk e dinte në cilin, sepse ishte harrestar i madh... Në çast para më doli Çehovi! Më shikoi gjatë, pastaj më tha:

"Nuk shkoj askund! Në fakt, nuk di as vetë se për ku jam nisur, sepse më ka humbur bileta. Në biletë shkruante vendi ku do të shkoja..."

Në çast, shoferi e ndali kamionetën pranë do varreve. Mua më thanë të rrija pranë një varri...

"Merr shatin dhe lopatën e hape varrin!", më urdhëruan. "Nuk është varr luftë!", u thashë.

"Hape ose të vrasim!", më urdhëruan.

Dhe, teksa e hapja varrin, mendime e mendime më vinin në kokë: I kujt është varri? A do gjejmë gjë në të a jo? E, kur veç dolën eshtrat e të vdekurit, me brushë arkeologjike fillova t'i pastroja eshtrat...

Dhe, posa ia pastrova mjekrën, i dolën dhëmbët jashtë dhe më trishtuan...

Por, falë Zotit, më doli gjumi dhe i tëri isha djersitur e bërë qull...

Fill e falënderova Zotin që nuk ishte skenë reale, por një ëndërr e trishtuar dhe hiçgjë më shumë...

Në çast mendja përsëri më shkoi te ëndrra: A mos, në atë varr, ishte njeriu i aksidentit në Slloveni dhe në trupin e tij ishin protezat prej ari?

E VËRTETA E HIDHUR...

Kaloi ora 3 e natës, e unë ende trishtohesha nga ëndrra që e përshkrova më parë.

Gruaja u zgjua nga shtrati dhe, pasi piu një gotë ujë, u shtri përsëri afër meje...

Si në kllapi shtrati më shkonte sa andej e sa këndeje, majtas e djathtas.

"Eh, qe sa kohë, o Zot, është bërë gruaja ime e fuqishme, sa ta lëvizë shtratin sa në një anë e sa në tjetrën?! Apo po ndodhë tërmet?!", e solla në mendje.

Dhe, nga kati i gjashtë i banesës dolëm jashtë...

Njerëzit vraponin shkallëve dhe ulërinin. Secili mundahej të lajmëronte tjetrin në telefon...

Njëri thoshte se vetëm tërmeti i parë paraqet rrezik, e të tjerët jo...

"Ti je ekspert i

kësaj fushe, që po i di këto probleme, a?", e pyeti një zonjë.

"Jo, unë jam bujk. Jam mysafir te motra", ia ktheu ai. Dhe, kur dëgjova se edhe bujku po dinte për tërmetet, mendja më shkoi te kusha im, i cili sa herë që flitej për Amerikën, fliste si të ishte lindur e rritur atje.

E, ai kurrë nuk kishte shkelur me këmbë në Amerikë!

"Ti, bre djalë, je i lindur e rritur në Amerikë, apo ke shkuar më vonë?", e pat pyetur një plak.

"Jo, kurrë s'kam qenë në Amerikë, por më ka treguar axha", ia ktheu ai.

PLAKA DHE ANANASI

Një grua i thotë një plake:

"Hallë ti paske hëngër ananas dhe e paske hequr zhigun e ujit!"

Plaka, e që i tregonte po asaj gruajë për ananasin, i tha:

"Jo, unë s'kam hëngër kurrë ananas, por më ka treguar mbesa ime, se ajo ha shpesh".

Safet Krivaça

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play

Shkabaj
Fillo këtu.
www.shkabaj.net

Pse gruaja e tjetrit është më e mirë se e jotja?

Histori është edhe dashuria. Qëllova pranë dy zonjave që po flisnin për dashuri. Pinin makiato dhe flisnin për dashuriçkat e dikurshme.
“Ah, pasha atë kohë!”, tha njëra prej tyre.



Unë nuk kam pirë makiato ka disa ditë. Disi po ma tollogjitë barkun dhe kam vendosur të pi çaj të zi.

Dhe, tek i shoh se si e pinë me shije, më shkon mendja ta kthej përsëri makiaton. Por, që ta kthej shijen e tyre, po u dashka të flas për dashuri...

Ama, them me vete, këto nuk e kanë mirë! Edhe para se të kenë dashuruar, ka ekzistuar dashuria. Dikush ka dashuruar edhe para tyre. Dikush e ka ndjerë shijen e buzëve edhe para tyre.

E, kush mund të ketë dashuruar i pari? Zoti e di...

Zonjat flasin si në garë dhe kreken secila me shpjegimin e vet si e ka dashur dhe si janë dashuruar me filan fistekin.

NJË VIT E PRES PËR DY JAVË KËNAQËSI!

Në ato mendime vjen miku im. Është këngëtar.

“Ti di shumë këngë dashurie, miku im”, e hapi muhabetin unë.

“Di shumë. Këndo kështu dashurie në

dasma e ahengje, por edhe në repertorin tim, e që janë pjesë e albumeve. Po, çka hyre këtu?”, më thotë duke qeshur.

“Po flasin ato dy zonja se si kanë dashuruar dikur... Ndërkaq, thonë fjalë të këqija për burrat e tyre”, i them unë.

“Më i keq se burri im s’ka! Është tepër egoist, vetëm për vete mendon. Ma ka lodhur shpirtin. E kam zënë sa e sa herë me të tjera, por kurrë as s’i kam thënë pse e qysh! Kur nuk e do, nuk ke qejf as në shtrat me i shkua, por s’ke çka bën!

Por, ende takohem me të dashurin tim dhe ai po më kënaq. Një vit e pres për dy javë kënaqësi, sepse ai jeton në Gjermani”, flet ajo që duket paksa më e vjetër me moshë se tjetra.

Tjetra ia kthen shpejt e shpejt:

“Po t’i tregova problemet e miat, të bien lotët mbi filxhan! Kam vuajt nga burri. E pat kuptuar që e kam pasur një lidhje më herët dhe më pyeti se a kam pasur me ndokënd punë... E, unë e mohova...

Por, kështu e paska jeta: ai më do mua, unë dikë tjetër!”.

PSE KËNGËTARËT NUK KËNDOJNË PËR GRUAN E VET, POR PËR GRATË E HUAJA?

E, miku im këngëtar, më thotë:

“A ke dëgjuar ndonjëherë se dikush i ka kënduar këngë gruas së vet? Të gjithë këndojnë për gratë e huaja!”.

Dhe, në këtë mesele mu kujtua një batutë. Kur e ka pyetur gruaja burrin sa më do, ai i ka thënë shumë të dua.

“E, meqë më do shumë, pasi të vdesë çka do bësh?”, e ka pyetur ajo.

“Nëse ti vdesë, unë çmendem!”, i ka thënë ai.

“Lëre çmendenë, ore, por a martohesh ajo?”, ia kthen ajo.

“I çmenduri bën gjithçka! Andaj, mos ma zë për të madhe nëse çmendem e martohem...”, i thotë.

Sokol Murturi



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamt, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamt.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamtin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.



DAFINA OLLURI
ZV. DREJTORE-OPEN DATA KOSOVO

Të menduarit kritik dhe zgjidhja e problemeve janë nocione shumë aktuale në shkollat e shekullit 21, të cilat përbëjnë disa nga qëllimet kryesore në kontekstin e edukimit shkollor por edhe edukimit të përgjithshëm.

Të menduarit kritik është aftësia e analizës dhe vlerësimit të fakteve rreth një aspekti të caktuar që kontribuon në formimin e një mendimi apo qëndrimi rreth atij aspekti. Ndërtimi i aftësive të tilla tashmë është objektiv formal mësimi dhe pjesë e kurrikulave shkollore e pothuajse të gjithë mësuesve dhe profesorëve në të gjitha nivelet e arsimit edhe në Republikën e Kosovës por edhe në botë. Mësuesit më të vjetër, pothuajse të gjithë janë trajnuar nga organizata të ndryshme për të menduarit kritik, ndërsa ata që janë më të ri kanë mësuar këto koncepte edhe gjatë edukimit të tyre formal. Por, duke qene se në praktikën shkollore hulumtimi, debatet apo forma të ngjashme të mësim-nxënies gjejnë aplikim të kufizuar, mbetet ende një pyetje e hapur se sa arrihet që të zhvillohet të menduarit kritik dhe zgjidhja e problemeve tek të rinjtë tanë në procesin mësimor.

Industritë botërore tashmë janë duke kërkuar që zhvillohen më tutje nëpërmjet identifikimit të potencialeve të reja, si për lëndët e tyre të para, poashtu nëpërmjet përmirësimit të produkteve, zgjidhjeve kreative teknologjike e mënyrave të reja të komunikimit. Padyshim që, industritë e sotme kanë arritur një shkallë të lartë të zhvillimit prandaj avancimi i tyre mund të vije vetëm nga inovacioni dhe jo nga evlucioni normal i zhvillimit të tyre. Të menduarit kritik është mënyra më efektive e zgjidhjeve të problemeve që këto industri mund ta hasin por edhe mundësi për zbu-

Mendimi Kritik dhe Programimi: Aftësitë kyçe për zhvillimin e fëmijës në shekullin 21

lime të reja në fusha të ndryshme. Prandaj, të menduarit kritik shërben që nxënësit/studentët të mësojnë nga vet procesi i të nxëniti duke pasur mundësi të sfidojnë të gjithë procesin dhe jo vetëm të fokusohen më mësimin e rezultateve të gatshme dhe njohurive ekzistuese që tashmë gjinden në literaturë.

Normalisht, të menduarit kritik si koncept i ri, pothuajse rreth 20-vjeçar në vendin tonë, kërkon një qasje të re, tjetër nga ajo e fokusit vetëm në të mësuar formal. Të menduarit dhe kritika gjatë procesit të mësimi shërbejnë shumë për të arritur rezultatet më të mira dhe për të kompletuar profilin e një nxënësi/studenti në vazhdimësi.

Të menduarit kritik si një aftësi për të menduar qartë dhe në mënyrë racionale si edhe për të kuptuar dhe lidhur në mënyrë logjike idetë, është veçmas i domosdoshëm në fushën e teknologjisë informative.

Teknologjia informative tashmë nuk është vetëm ndihmuese në procese të ndryshme industriale, ajo është vet industria. Në një renditje të aftësive të reja dhe vendeve të punës, të përgatitur nga portali i njohur indeed.com, aftësitë kryesore të kërkuara tani në botë renditen si më poshtë: të dhënat kompjuterike në hapësirë (cloud computing), inteligjenca artificiale, lidhshimi i shitjeve, analizimi, përkthimi, zhvillimi i aplikacioneve mobile, menaxhimi i njerëzve, prodhimi i videove dhe audio-prodhimi, blockchain, kreativiteti, etj. Nga një listë prej 20 aftësive të domosdoshme për të ardhmen, mbi gjysma e tyre janë drejtpërdrejtë pjesë e fushës së teknologjisë informative, derisa edhe gjysma tjetër e tyre përfshinë në mënyrë aktive përdorimin e teknologjisë informative.

Zhvillimi i teknologjisë i hovshëm dhe imponimi i saj si pjesë e jetës së përditshme ka mundësuar që, paragjykimet që kanë ekzistuar sidomos gjatë shekullit 20, se inxhinieria dhe teknologjia i takojnë më shumë botës mashkullore tashmë kanë mbetur vetëm pjesë e historisë. Numri i vajzave dhe djemve që mësojnë kodim

dhe programim është pothuajse identik në moshat e reja edhe në Republikën e Kosovës. Përvojat edhe personale të ekipit tonë në Open Data Kosovo, ku 3 udhëheqëse kanë arritur të futen edhe në listën e gazetës prestigjioze Forbes 30 Under 30, tregon se në këtë fushë gjinia nuk është përparësi apo mangësi. Thjeshtë ju duhet vizioni, një kompjuter dhe filloni punën, qoftë duke mësuar kodimin online apo duke u bërë pjesë e kurseve të shumta që ekzistojnë tanimë në Kosovë.

Natyrisht të gjitha këto aftësi të avancuara vijnë në shprehje, pas shkrimit dhe leximit dhe njohurive tjera elementare, por që të gjitha këto kërkojnë një qasje kreative të të menduarit kritik, përkundër, mësimi memorizues tradicional që ka pasur për qëllim mbajtjen mend të shumë rezultateve pa një fokus të madh në vet procesin se si kemi ardhur te rezultati.

Teknologjia e informacionit ka ndryshuar gjithçka në funksionimin tonë, që nga jeta jonë personale deri tek ajo e avancuar profesionale. Tashmë shumë gjëra bëhen online, që nga blerjet dhe shitjet e zakonshme, shfletimi i gazetave dhe portaleve e deri tek njohja me njerëz. Kur shohim procese të ndryshme të komplikuar duke funksionuar online, si tregjet e stogëve të kompanive më të mëdha botërore, ndërsa ne kemi mundësinë që me disa klikime të investojmë në to, ndonjëherë na shfaqen para nesh imazhe të programerëve kompjuterik, duke i imagjinuar ata të mbyllur në një dhomë të errët që nuk ndalen duke punuar mbi 20 orë në ditë.

Megjithatë, lajmi qëndron në atë fakt që sot, edhe kodimi dhe programimi janë thjeshtëzuar aq shumë, saqë pothuajse çdo kush dhe në çdo kohë mund të fillojë të programoj.

Programi tre-vjeçar rajonal "Shkollat e Shekullit 21", i zbatuar nga Këshilli Britanik (British Council) dhe i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, është i pranishëm në çdo shkollë fillore në rajon dhe do të mësojë deri në një milion nxënës mbi aftësitë e nevojshme për profesionet e së ardhmes.



Adresa: Rr. Eduard Mano, Kopshti Zoologjik 1001 Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 69 258 8889 ; **Web:** www.unikhotel.al; **Email:** info@unikhotel.al

Diçka me mua nuk është në rregull...

Pse burrin e dua si vëlla?

*Lidhja jashtëmarte-
sore më ka dërguar
në nivele të tjera të
dashurisë, duke më
bërë të ndjej gjëra që
s'i kam ndjerë për një
kohë të gjatë.*

Ndihem shumë e zemëruar me burrin tim, sepse nga ai kam pritur shumë e nuk ka dhënë asgjë. Dhe, kemi përfunduar në këtë pikë të krizës, ku edhe jemi tash...

Jam e martuar që 20 vjet dhe kam fëmijë. Unë dhe im burrë jemi përafërsisht të një moshe. Si njeri është shumë i mirë dhe e dua si vëlla, sepse ka kohë që dashuria që kisha për të më është larguar dhe tash kam ndjenjë tjetër...

NUK JAM LAVIRE PSE NJOHA NJË TJETËR...

Verës që shkoi, në Durrës u njoha me një burrë nga Gjilani. Me të

u njoha në shtëpinë ku banonim unë me familjen time dhe ai me të veten.

Dhe, teksa të tjerët rreziteshin në plazh, unë në njërën nga ditët nuk dola, meqë më erdhën menstruacionet. Për çudi, teksa qëndroja nën hijen e fikut të shtëpisë ku banonim, nga plazhi erdhi Demiri dhe u habit kur më pa se nuk isha në plazh.

Pasi u ul në ulësen afër meje, i porositi dy makiato, pa më pyetur fare doja apo s'doja të pija...

Dhe, pa i bërë asnjë pyetje filloi të fliste për jetën e tij. Marrëdhënia me gruan e tij ishte në krizë dhe kishte nevojë të hapej me dikë për problemin që e kishte në shpirt.

Unë e dëgjova sa e dëgjova dhe i thashë se më duhej të largohesha, sepse ishte koha kur im burrë me fëmijë veç pritej të ktheheshin nga plazhi.

Dhe, teksa u ngrita, më tha: "Nesër këtu, në të njëjtën kohë!"

PO TË JETOJ EDHE 100 VJET NUK DO E PËRJE- TOJ ATË KËNAQËSI!

U takuam të nesërmen po në të njëjtin vend, pimë kafe bashkë dhe mu lut që në mbrëmje të takoheshim në plazh, larg vendit ku rreziteshim.

E, kur errësira veç filloi ta mbulonte plazhin, u përvodha nga fëmijët e burri dhe dola në plazh, shumë larg shtëpisë ku banonim...

Ai veç ishte aty... Mu afrua, më rroku për beli dhe më puthi pa kurrfarë ngurrimi. Sepse, për fat të mirë, afër nuk kishte njerëz dhe në largësi nuk hetohej se ç'bënim ne...

Kur u ktheva në banesë, ndihesha shumë e lumtur, sepse një përvojë të tillë nuk e kisha bërë asnjëherë në jetë... Dy net më vonë u gjendëm shumë më larg banesës ku banonim. Dhe, pas disa shkurreve në plazh bëmë seks, të cilin edhe po të jetoj edhe 100 vjet nuk do e përjetoj një kënaqësi të tillë...

V. Zh.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

Jam e martuar qe dy vjet dhe ende virgjine!

Jam Drenusha, nga Peja, 37 vjeçe. Kam pasur të dashur, por nuk ishte kështet të martoheja dhe lidhjet përfundonin shpejt. Por, njohja me Endritin nga Gjermania i ndryshoi gjërat...

Njohja me Endritin i ndryshoi gjërat. Më njohu me Endritin kushëriri im, i cili ndodhej në Gjermani. Ma dha në telefonin dhe biseda jonë e parë zgjati hiç më pak se një orë. Folëm e folëm derisa edhe u lodhëm...

Dhe, si përfundim, e përmbyllëm bisedën që të dëgjoheshim edhe ditëve të tjera. Por, kaloi një javë dhe më as kushëriri im e as Endriti nuk më telefonuan. Mendova se kishte qenë lojë dhe asgjë më shumë. Dhe, mu në kohën kur mendova se s'kishte gjë nga ajo punë, në telefonin tim erdhi një thirrje pa numër. E hapa. Ishte Endriti. Më tha se kishte pasur punë shumë dhe nga lodhja nuk kishte pasur as si t'më lajmërohej. Më tha se muajin tjetër do të

vijë në Kosovë, jo se kishte punë, por që të takoheshim.

NGA GJERMANIA NË KOSOVË PËR NJË NJOHJE!

Thënë të drejtën, u befasova: tërë atë rrugë për një njohje!

Dhe, erdhi edhe dita të takoheshim. Dola në aeroportin e Prishtinës dhe e pritja. Nga larg e njoha në bazë të fotove të shumta që m'i kishte dërguar. Ishte edhe më i bukur se në foto...

Nga aeroporti u nisëm për në Pejë me veturën time. Në hotelin "Nora" u ndalëm në kafe. Ndenjëm aty një dy orë dhe ai, thënë shkurt, më pëlqeu shumë në bisedë.

E, kur u ndamë në Pejë më tha se dëshiron të njihet edhe me familjen time. Dhe, ashtu ndodhi. Tri ditë më vonë ai erdhi te ne. U njohë me babanë dhe tim vëlla.

Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë edhe u fejua, ashtu shpejt e shpejt dhe u morëm vesh që gjatë verës edhe të martohejmë, në mënyrë që të fillojë procedurën për bashkim familjar, e që para vitit të ri shpresoja të shkoja te ai.

Në muajin gusht u martuam, me një dasmë shumë simbolike. Ai më mori me pak krushq dhe me dërgoi në shtëpinë e tij. Erdhi edhe koha e gjumit.

MË KAPLUAN ETHET SE ISHTE NATA E PARË ME NJË MASHKULL!

Thënë të drejtën, para se të binim, më rrokën do ethe nga frika, sepse për mua ishte nata e parë që bëja gjumë me një mashkull, andaj në kokën time silleshin lloj-lloj mendimesh. Si do të jetë hera e parë?

Dhe, hera e parë ndodhi shumë thjesht. Posa ramë në shtrat atë e zuri gjumi!

Në mëngjes u arsyetua se ishte i lodhur nga dasma dhe nuk kishte dëshirë që të bënim seks vetëm sa për sy e faqe...

Në natën e dytë, ende pa rënë me fjet, një telefonatë i erdhi nga Gjermania.

Bosi e thërriste të kthehej menjëherë në punë! Kjo bëri që ai kinse u shqetësua, e edhe nata e dytë kaloi bosh...

Ditën e tretë e përcolla në aeroport dhe me një shtrëngim duarsh edhe u ndamë, ai duke hyrë në aeroplan e unë duke u kthyer në shtëpinë e prindërve të mi...

Tash, edhe pse janë bërë dy vjet e martuar, ende jam virgjine! Ende pres se si do të ishte hera e parë... E, si do të jetë ajo hera e parë, një Zot e di!

Drenusha, Gjermani

Me 3 gjëra e rrëzoni përtokë Ujorin!

Ujori është unik, i paparashikueshëm, origjinal, optimist dhe i shoqërueshëm. Por, me tri gjëra e rrëzoni përtokë. Cilat janë ato?

1.

Kjo shenjë e zodiakut mund të parashikojë paraprakisht të gjitha zgjidhjet e mundshme për një problem që njerëzit e tjerë nuk i shohin.

Ujorët, thjesht, nuk mund të qëndrojnë kur u thuhet se duhet të bëjnë diçka në një mënyrë specifike, ndërsa shohin alternativa të ndryshme krijuese që do të kishin të njëjtin efekt.

Ju gjithmonë mund të mbështeteni te ta, që të gjejnë qasjen e tyre unike për zgjidhjen e një problemi ose detyre, në vend që të ndjekin një strategji tradicionale.

Sigurisht, kur nuk ka zgjidhje tjetër dhe rregullat duhet të ndiqen, ata do ta bëjnë këtë, por do të zhgënjehen, pasi janë të detyruar të ndjekin rregulla që ata besojnë se nuk janë të nevojshme.

2.

Ujori vlerëson pavarësinë dhe vetminë më shumë se çdo shenjë tjetër e zodiakut. Për ta nuk ka situata që nuk mund t'i kalojnë vetë, madje edhe momentet më të vështira dinë t'i përballojnë. Pa dyshim, kjo nuk do të thotë se ata nuk e vlerësojnë kompaninë dhe mbështetjen e njerëzve të

afërt. Ata, thjesht, duhet të kenë kohë për veten e tyre, kështu që pasi të rrinë jashtë, bateritë janë aq të mbushura dhe truri pushon.

3.

Ujori kujdeset shumë për të dëgjuar pozicionin e tyre. Mendimi se idetë dhe mendimet e tyre nuk kanë vlerë, mund t'i zemërojë dhe lëndojë ata.

Edhe pse, ndonjëherë, duken paksa të rezervuar, madje edhe të ndrojtur, ata janë gjithmonë të gatshëm të thonë qartë dhe me zë të lartë atë që mendojnë, edhe kur bëhet fjalë për tema të pakëndshme.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Pse i humbën ndjenjat burrit?

Jam grua, 38-vjeçare, kam fëmijë, jetoj jashtë vendit. Ka kohë që burri nuk ka ndjenja për mua!

Jam munduar në shumë aspekte ta ofrojë pranë vetes nga ana emocionale, por kot.

Kemi biseduar herë pas herë për këtë problem dhe nuk e di arsyen pse ka ardhur te kjo situatë.

Kështu, të paktën, më thotë mua...

Më është bërë bajat jeta me të...

Jam në pikë të hallit: të ndahem apo të jetoj me të?

"Brenga 1"

Përgjigje:

Para së gjithash, duhet të dihet e vërteta pse ka ndodhur ky defekt. Nëse ndryshimi ka ndodhur për shkaqe shëndetësore, duhet ta pranosh jetën e tillë si bashkëshorte e tij besnike.

Por, nëse ndryshimi te burri ka ndodhur shkaku i aventurave të tij, e drejta jote për të zgjedhur një mënyrë jete që të përshtatet është legjitime.

Ky është një standard parimor i përafërt edhe me kodin popullor edhe me atë shkencor e social.

Unë shoh se ju asnjëri nuk keni jetuar besnikërisht në bashkëshortësi. As ti nuk je në nivelin e ndjenjave për burrin e as ai për ty. Ky është treguesi më i saktë i gjendjes suaj. Nuk duhet ta prishni bashkëshortësinë, meqë asnjëri nuk jeni në rregull. Ai e ka hetuar gjendjen tënde dhe ka ndryshuar negativisht për ndjenjën ndaj teje, prandaj duhet të bashkëbisedoni dhe ta harmononi të kaluarën e afërt që u ka bezdisur në mos-harmonizimin bashkëshortor.

Por, ka gjëra që i bien në mendje edhe burrit për ty dhe e kthen në të kaluarën. E, kjo është arsyeja pse nuk është ai në rregull.

M'i mori 15 vjet. A më ka borxh?

Zonjë e nderuar, jam një vajzë rreth të 40-ave, e punësuar në një firmë shoqërore. Para 15 vitesh mendova se

gjeta njeriun e jetës sime dhe prej atëherë jemi bashkë.

Lidhjen tonë e dinë shumë njerëz, por ai është i martuar. Rininë e kam quar me të dhe ia kam dhuruar tërësisht jetën time.

Tash, që i kam bërë do vite, a kam të drejtë të kërkoj prej tij t'më blej shtëpi a banesë, sepse i ka kushtet dhe mundësitë?

"Bora"

Përgjigje:

Nëse ai ka qenë i martuar kur edhe jeni njohur dhe nëse ai të ka treguar objektivisht se ka grua e fëmijë, nuk ke të drejtë të ngulësh këmbë në këtë kërkesë për shtëpi apo banesë.

E, nëse të ka premtuar se keni për të qenë bashkë, mirë është të të bëjë zgjidhje dhe ta bëjë publike lidhjen tuaj, që edhe ashtu veç dihet.

Normalisht, do ishte dashur që ai të bëjë zgjidhje me ty, sepse 15 vjet lidhje janë shumë për të të lënë në baltë, sidomos tash kur je mësuar me të.

Kjo do të ishte normale, por deri diku edhe e obligueshme për të, nëse ai është njeri korrekt.

Lidhja juaj edhe ashtu ka ardhur te pika ku duhet ta merrni një vendim. Ndarje s'mund të këtë, prandaj kur nuk ka ndarje dihet se ka bashkim.

Shpreso në këtë mundësi, edhe pse nuk është i lehtë bashkimi juaj pas kaq shumë vitesh. Por, dini se nuk do jeni as të parët e as të fundit. Fati shpesh i qon gjërat në drejtim të kësmetit.

Nëna më la te prindërit e vet!

Unë që të shkruaj tash jam një nënë, por me shumë halle. Nëna më kishte lënë te prindërit e vet, qyshkur isha tetë muajsh dhe kurrë nuk është lajmëruar.

Më ka rritur gjyshja, të cilën e kam ditur si nënë. Babai im ishte martuar me grua tjetër, gjë që unë nuk e kam ditur historinë time.

Por, gjyshja më tregoi një javë pa vdekur se nëna jote të ka lënë te ne dhe ka ikur...

Nuk di a është martuar apo jo, sepse kurrë nuk më ka kërkuar?! Dhe, prej kur ma ka treguar historinë gjyshja, jam me lot në sy dhe më qan zemra e shpirti...

Kohëve të fundit më është bërë pikë në zemër: Pse nuk më kërkoi kurrë?! Ku është? Ç'bën? Si mundet një nënë të mos e kërkojë kurrë fëmijën e vet?!

"Je-ti--"

Përgjigje:

Kërkoje nënën dhe kjo është e drejta jote e patjetërsueshme. Ajo të ka lindur me njeriun që ka qenë e martuar dhe martesë nuk ka ndodhur tinëz, por në mënyrë të rregullt dhe me traditë.

Edhe burri aktual që e ka nëna jote e di se ajo e ka pasur një vajzë dhe e ka lënë. Andaj, çfarë problemi ke për t'i nxjerrë nënës nëse e kërkon për ta parë?!

Nuk do kërkojë nga ajo asgjë finansiare, por kërkon ta njohësh

dhe hiçgjë më shumë...

Pra, kjo është kërkesa jote më normale në jetë, sepse nuk ka diçka më të shenjtë e humane sesa ta kërkojë nënën që të ka bartur në barkun e saj...

A do të kem fëmijë?

Përsëndetje! E kam një mërzi të madhe që 4 vjet. Jam e martuar, por ende nuk kam fëmijë.

Kemi qenë nëpër mjekë e hoxhallarë, por të gjithë na kanë thënë që s'kemi probleme dhe duhet të kemi durim.

Ju lutem, pse ende nuk kam fëmijë? A kemi magji apo diçka tjetër?

"E mërzitura"

Përgjigje:

Ju duhet ta vërtetoni gjendjen tuaj shëndetësore gjinekologjike te eksperti mjekësor, në mënyrë që të bazoheni te të dhënat laboratorike nëse janë në rregull ciklet mujore, ovulacioni dhe spermografia jote dhe e burrit.

Dhe, nëse të gjitha këto janë në rregull, atëherë mungesa e shtatzënisë mund të jetë pasojë e gjendjes stresuese apo traumatike, por edhe e mundësisë së të bërave të ndryshme, që, të paktën, qëndrojnë si frikë apo dyshim në sistemin tënd psikomotorik.

E, nëse krejt këto janë mirë, atëherë duhet të keni arsye që të prisni shtatzëninë e parë së shpejti...

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

A do të rehatohem me të fejuarin?

Jam një vajzë 28-vjeçare, jetoj në Prishtinë. Para një jave jam fejuar me një djalë jashtë vendit, në Zvicër.

A do të rehatohem me të?

"Pa shifër"

Përgjigje:

Vetë fakti se ke shtruar një pyetje të tillë, sjell dilema enigmatike. Është keq kur bën fejesë me dy mendje, siç ke bërë ti...

Me siguri, me që ai jeton në Zvicër, mendon se kushedi çka ka bërë atje dhe sa femra i ka pasur!

Prandaj, hiqe atë dilemë! Ke pranuar të bësh fejesë dhe sillu me mendje të mirë dhe të duhur.

Mos bëj gabime që nuk duhet bërë dhe ajo çka të përket ty është që pjesën tënde të përgjegjësisë bëje korrekt, e ai duhet ta bëjë pjesën e vet që i takon ndaj teje.

Megjithatë, mentalitetet tuaja kanë shumë dallime. Ti e lindur e rritur në Prishtinë, e ai i lindur e rritur në Gjenevë, pa dyshim, ka shumë dallime.

Por, nuk do të thotë se nuk do të keni mirëkuptim.



SHERWOOD

Resorts and Hotels

Feel the Legend

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
PRIZE HOTEL**
LARA / ANTALYA

+90 242 444 88 07
www.sherwoodhotels.com.tr



UB

UNION BUSINESS ALBANISCH & DEUTSCH

Unioni i Bizneseve
Shqiptare Gjermane
përshëndet dhe uron
krijimin e qeverisë së re në
Kosovë nën mandatin e
Kryeministrit z. Albin
Kurti.

Unioni i Bizneseve nga
Gjermania falenderon
poashtu qeveritë e kaluara
të Kosovës, së fundi
qeverinë e Kryeministrit z.
Hoti, për mbështetjen dhe
bashkëpunimin e ndërsjellë
në projektet dhe
organizimet e Unionit.



UB i dëshiron punë të
mbarë dhe suksese qeverisë
së re, fillimisht në luftën
kundër pandemis dhe në
proceset e ndërtimit dhe
përmirësimit të jetës
ekonomike dhe sociale të
çdo qytetari në Kosovë.
Kto mundën të ndërtohen
me implementimin e
niveleve profesionale
humane dhe ekonomike në
strukturat përkatëse
shtetërore. Me ngritjen e
atraktivitetit investues nga
jashtë dhe krijimin e një
klime stabile dhe të
besueshme për afaristët dhe
gjithë qytetarët e Kosovës

Mbetëmi më shpresë dhe
pritje që qeveria e re në
vazhdimësi do ta mbështet
Unionin në rrugën e
vazhdimit të projekteve të
startuara në kuadër të
platformës së
bashkëpunimit dhe
investimeve të përbashkëta
të anëtarve të Unionit në
Kosovë.

Punë e mbarë dhe suksese!

Me Respekt, Kryetari i
Unionit
Nazmi Viqa